

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16 dhe 11/18) dhe nenit 10, 22 dhe 41 të Ligjit për Qytetin e Shkupit ("Gazeta zyrtare e RM-së nr. 55/04),

QYTETI I SHKUPIT

shpall

THIRRJE PUBLIKE

për mbledhjen e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2021, të dedikuara për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2021

I

Për realizimin e nevojave publike në fushën e kulturës, Qyteti i Shkupit shpall Thirrje publike për mbledhjen e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për vitin 2021, të dedikuara për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës me interes për qytetin e Shkupit për vitin 2021.

Veprimtaritë nga fusha e kulturës, programeve, manifestimeve dhe mjetet financiare për realizimin e tyre, përcaktohen përmes programit vjetor për kulturë dhe me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin 2021.

II

Në Thirrjen publike, të drejtën e pjesëmarrjes e kanë artisët, artistët e pavarur, institucionet nga fusha e kulturës, shoqatat civile, fondacionet, institucionet kombëtare he personat tjerë juridik dhe fizik të cilët ushtrojnë veprimtari nga fusha e kulturës në pajtim me Ligjin për kulturë dhe dispozitat tjera pozitive ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

III

Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë në financimin e programeve, projekteve dhe të aktiviteteve në pajtim me legjislativin ligjorë, në bazë të *"Qëllimeve dhe kriterëve të përcaktuara për zgjedhjen e projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit"*, me sa vijon:

- Përkrahja e projekteve, manifestimeve dhe e aktiviteteve nga fusha e veprimit profesional, amatorë dhe rinorë në fushat vijuese:
 - 1.1. Arte performuese
 - 1.2. Arte muzikore
 - 1.3. Arte vizuale dhe arte të medimeve të reja
 - 1.4. Veprimtari botuese dhe bibliotekare

- 1.5. Veprimtari muzeore, promovim i trashëgimisë kulturore
- 1.6. Bashkëpunim ndërkombëtar

IV

Përskaft fushave të theksuara specifike, fletëparaqitjet e parashtuara duhet ti përmbushin edhe “Qëllimet dhe kriteret për zgjedhjen e projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit”, që janë ofruar si shtojcë e Thirrjes publike, të shpallur në Ueb portalin zyrtarë të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

V

Paraqitja në Thirrjen publike realizohet në trajtë elektronike edhe atë në linkun vijues:

https://skopjelab.typeform.com/to/JcpMBpJp?fbclid=IwAR3BRTL7MGc5XPmLIJhpEiE1YwazA5C6HuytKg5TnRagu_uEKAXad5Kczc

Aplikimi mund të gjendet në Ueb portalin zyrtarë të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk.

VI

Thirrja publike vlen për aplikuesit me adresë të banimit në Qytetin e Shkupit dhe për ata që posedojnë veprimtari të regjistruar në Qytetin e Shkupit.

VII

Thirrja publike zgjat nga 1.10.2020 deri më 31.10.2020, përkatësisht, 31 ditë të kalendarit nga dita e shpalljes në ueb portalin zyrtarë të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk

Vërejtje: Fletëparaqitjet elektronike me të dhëna dhe dokumentacione të pa kompletuara, fletëparaqitjet e plotësuara në formularët jo përkatës, si dhe aplikimet të cilat nuk do të parashtrohen në afatin e theksuar, nuk do të shqyrtohen.

Rezultatet e thirrjes publike do të shpallen në “Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” dhe në ueb-faqen zyrtare të Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk, me Aktvendimin për financimin e programeve dhe projekteve nga fusha e kulturës me interes për Qytetin e Shkupit për vitin 2021.

Informacione plotësuese mund të merren në telefonat: 02/ 3297-289, 02/3297-243 dhe në e-mail adresën e mëposhtme kultura@skopje.gov.mk.

**Kryetari i Qytetit të Shkupit
Petre Shilegov**
